

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
 SH. A. PEJË**



Zyret qendrore
 Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
 Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Duke u bazuar në nenin 34 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjen Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, Ligji nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe bazuar në nenin 7 të Statutit të Ndërmarrjes Publike K.R.U “Hidrodrini” Sh.A., Bordi i Drejtorëve i K.R.U. “Hidrodrini” SH.A.-Pejë në mbledhjen e mbajtur më 10.07.2026, shqyrtoi Rregulloren për Provizionimin e llogarive të arkëtueshme, dhe lidhur me të njëjtin, njëzëri, miratoi:

Vendim: Nr.20/2026

REGULLORE PËR PROVIZIONIMIN E LLOGARIVE TË ARKËTUESHME

	Delegoi	Aprovoi
Emri dhe Mbiemri	Dri Cena Kryeshef Ekzekutiv	Qendresa Kukaj Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
Nënshkrimi		
Data	10.07.2026	10.07.2026



**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A. PEJË**



Zyret Qendrore

Rr. Lekë Dukagjini nr 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Duke u bazuar në nenin 34 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjen Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, Ligji nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe bazuar në nenin 7 të Statutit të Ndërmarrjes Publike K.R.U “Hidrodrini” Sh.A., Bordi i Drejtorëve i K.R.U. “Hidrodrini” SH.A.-Pejë, në mbledhjen e mbajtur më 10.07.2026 miratoi këtë:

**REGULLORE NR. 03/2026 PËR PROVIZIONIMIN E LLOGARIVE TË
ARKËTUESHME**

Pejë, 2026

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i rregullores është ndërtimi i një procesi efikas dhe efektiv për trajtimin e llogarive të arkëtueshme të K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. Përmes kësaj rregullore do të definohet qartë mënyra e kalkulimit dhe trajtimi kontabël i provizioneve. Të gjithë këta hapa janë të nevojshëm që të adresohen kërkesat nga SNK/SNRF me theks të veçantë të SNRF 9 dhe SNRF 13.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Rregullorja do të zbatohet nga departamentet e përfshira në procesin e trajtimit të llogarive të arkëtueshme, sidomos nga departamenti financiar si dhe ai komercial.
2. Kjo rregullore do të përdoret për qëllime të mbajtjes së evidencave për llogaritë e arkëtueshme raportimin e tyre konform SNRF/SNK, dhe nuk do të trajtoj aspektet tatimore lidhur me kërkesat që dalin nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **PPF** — Pasqyra e Pozitës Financiare — Bilanci i Gjendjes
 - 1.2. **KE** — Kryeshefi Ekzekutiv
 - 1.3. **BD** — Bordi i Drejtorëve
 - 1.4. **SNK** — Standardet Ndërkombëtare të kontabilitetit
 - 1.5. **SNRF** - Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
 - 1.6. **Llogaritë e Arkëtueshme** — është vlera e borxheve të cilën konsumatorët i obligohen K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. — Pejë.
 - 1.7. **Provizionet e Llogarive të Arkëtueshme** — është vlera e cila rezulton gjatë kalkulimit të amortizimit (dëmtimit) të llogarive të arkëtueshme konform kërkesave për metodën e kostos së amortizuar në SNRF 9. Çdo fund vit Ndërmarrja do të testojë vlerën e zhvlerësimit (dëmtimit) të llogarive të arkëtueshme, nëse rezulton se kemi ngritje të vlerës kjo pjesë njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave, nëse rezulton e kundërta do të njihen si të hyra në pasqyrën e të ardhurave. Vlera totale e provizioneve është një kundër llogari e cila gjatë paraqitjes e redukton vlerën e Llogarive të Arkëtueshme.

Neni 4

Parimet e përgjithshme dhe financiare

1. Konform kërkesave ligjore ndërmarrja do të veprojë në frymën e parimeve të ligjeve të aplikueshme, përderisa trajtimi dhe aktivitetet e planifikuara do të jenë në harmoni me kërkesat që rrjedhin nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK).
2. Në parimet e përgjithshme të cilat Ndërmarrja i aplikon janë efikasiteti, transparenca, barazia në

trajtim dhe jo-diskriminim.

Neni 5

Viti fiskal

1. Viti fiskal konform kërkesave ligjore, fillon më 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor të vitit përkatës.

Kategorizimi i llogarive të arkëtueshme

Neni 6

1. K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A, me qëllim që të ketë pasqyrë sa më të qartë të rrezikshmërisë/riskut në lidhje me inkasimin e llogarive të arkëtueshme, do të marrë parasysh fillimisht në konsideratë rregullsinë e konsumatorëve në procesin e pagesës së borxheve nga periudhat e kaluara.
2. Kompania aplikon pagesat aktuale kundrejt faturës më të vjetër të pa-paguar të konsumatorit (e cila i ngjason metodës FIFO).
3. Për këtë qëllim Kompania ka zhvilluar mundësinë softuerike, e cila do të kalkuloj për secilin konsumator numrin e ditëve që kanë kaluar që nga fatura me e vjetër e pa-pagur e deri në datën e përgatitjes së pasqyrave Financiare.

Neni 7

Kategoritë e konsumatorëve

1. K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A., do të bëjë kategorizimin e konsumatorëve sipas metodës në vijim:
 - i. **Kategoria H** - Të gjithë konsumatorët të cilët kane fatura të hapura (pa-paguara) prej më shumë se 3 vite (1095 ditë).
 - ii. **Kategoria G** - Të gjithë konsumatorët të cilët kane fatura të hapura (pa-paguara) prej më shumë se 2 vite (730 ditë), por më pak se 3 vite (1095 ditë).
 - iii. **Kategoria F** - Të gjithë konsumatorët të cilët kanë fatura të hapura (pa-paguara) prej më shumë se 1 vit (365 ditë), por më pak se 2 vite (730 ditë).
 - iv. **Kategoria E** - Të gjithë konsumatorët të cilët kanë fatura të hapura (pa-paguar) prej më shumë se 180 ditë, por më pak se 365 ditë.
 - v. **Kategoria D** - Të gjithë konsumatorët të cilët kane fatura të pa-paguara prej më shumë se 90 ditë, por më pak se 180 ditë.
 - vi. **Kategoria C** - Të gjithë konsumatorët të cilët kane fatura të pa-paguar prej më shumë se 60 ditë, por më pak se 90 ditë.
 - vii. **Kategoria B** - Të gjithë konsumatorët të cilët kane fatura të pa-paguar prej më shumë se 30 ditë, por më pak se 60 ditë.
 - viii. **Kategoria A** - Konsumatorët të cilët kane fatura të hapura prej 1 deri në 30 ditë.

Neni 8

Metodat e provizionimit

1. Kompania i njeh dy metoda lidhur me provizionimin e llogarive të arkëtueshme:
 - 1.1. Provizionimi i përgjithshëm - sipas këtij modeli në rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare, Kompania do të bëjë provizionim të llogarive të arkëtueshme duke u bazuar në

probabilitetin e përgjithshëm duke u bazuar edhe nga e kaluara. Këtu do të përdoret kategorizimi i mësipërm i konsumatorëve. Kjo metodë pritët të jetë metoda e cila do të përdoret kryesisht nga kompania.

- 1.2. Provizionimi specifik - do të aplikohet në rast se Kompania ka informata së ndonjë konsumator specifik për ndonjë arsye të veçantë do të mund të shmangë pagesën e borxhit ndaj K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A.
2. Vlera totale e shumës së llogarisë lidhur me Provizionet e Llogarive të Arkëtueshme do të përbëhet nga Provizionimi i Përgjithshëm + Provizionimi Specifik¹.
3. Kompania gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, do të bëjë kalkulimin e shumës së provizioneve për llogaritë e arkëtueshme

Neni 9

Normat e provizionimit

1. K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A., gjatë kalkulimit të vlerës së provizionit të përgjithshëm, do të kalkuloj normat vijuese për secilën kategori të sipërpërmendur të konsumatorëve.
 - i. **Kategoria H** - Vlera totale e saldos së konsumatorëve të cilët i përkasin kësaj kategorie do të provizionohen **më normë prej 100%**.
 - ii. **Kategorie G** - Vlera totale e saldos së konsumatorëve të cilët i përkasin kësaj kategorie do të provizionohen **më normë prej 75%**.
 - iii. **Kategoria F** - Vlera totale e saldos së konsumatorëve të cilët i përkasin kësaj kategorie do të provizionohen **më normë prej 45%**.
 - iv. **Kategorie E** - Vlera totale e saldos së konsumatorëve të cilët i përkasin kësaj kategorie do të provizionohen **më normë prej 30%**.
 - v. **Kategoria D** - Vlera totale e saldos së konsumatorëve të cilët i përkasin kësaj kategorie do të provizionohen **më normë prej 25%**.
 - vi. **Kategoria C** - Vlera totale e saldos së konsumatorëve të cilët i përkasin kësaj kategorie do të provizionohen **më normë prej 10%**.
 - vii. **Kategorie B** - Vlera totale e saldos së konsumatorëve të cilët i përkasin kësaj kategorie do të provizionohen **më normë prej 2%**.
 - viii. **Kategoria A** - Vlera totale e saldos së konsumatorëve të cilët i përkasin kësaj kategorie do të provizionohen **më normë prej 0 %**.

Neni 10

Regjistrimi i provizionimit

1. Llogaria (konto) e Provizionimit të Llogarive të Arkëtueshme, është kundër llogari e kontos së Llogarive të Arkëtueshme, për këtë arsye edhe do të ketë saldo kreditore.
2. Në çdo fund vit ndërmarrja do të kalkuloj vlerën totale të provizionimit. Kjo vlerë rrjedhimisht do të krahasohet me saldën e provizioneve nga periudha paraprake.
3. Nëse në fund të kalkulimit shihet se kemi rritje të vlerës së provizioneve, regjistrimi do të jetë si në

¹ Kjo vlerë do të zbritet nga vlera e llogarive të arkëtueshme gjatë kalkulimit të provizionit të përgjithshëm

vijim:

Debi Shpenzimet e provizionimit të llogarive të arkëtueshme xxx(për diferencën e saldove)

Kredi Provizionet e llogarive të arkëtueshme xxx

4. Në të kundërtën nëse ndërmarrja sheh se kemi rënie të vlerës së saldës së provizioneve e bënë regjistrimin si vijon:

Debi Provizionet e llogarive të arkëtueshme xxx (për diferencën e totalit)

Kredi Të hyrat nga provizionet e llogarive të arkëtueshme xxx

Neni 11

Raportimi i provizioneve dhe llogarive të arkëtueshme

1. Ndërmarrja gjatë raportimit të pasqyrave Financiare do të paraqesë Llogaritë e Arkëtueshme Neto, pra Llogaritë e Arkëtueshme totale – Provizionet e llogarive në total.
2. Gjithsesi në shënimet shpjeguese ndërmarrja do të shpalosë vlerën e secilës nga llogaritë, pra do të jenë të qarta vlerat e llogarive të Arkëtueshme dhe vlera e Provizioneve të llogarive të Arkëtueshme.

Neni 12

Dispozitat Përfundimtare

Kjo rregullore hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Bordi i Drejtorëve të K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. – Pejë

Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve



Qendresa Kukaj – Prelvukaj